



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2021:219201

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647771

P.nr.154/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: D.M, për shkak të veprës penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 1, pika 1.3 të Kodit (Nr.06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1526/21, të datës 03.12.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 15.04.2024, në mungesë të prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit D.M dhe avokatit mbrojtës të tij, av.Festim Shala, me datë 16.04.2024 shpalli publikisht, ndërsa me datë 02.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

D.M, me nofkën "...", nga i ati R..., e ëma S..., e vajzërisë A..., i lindur me datë, në P..., me adresë të vendbanimit në fshatin R... – S..., me profesion punëtor, i diplomuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 23.03.2021, në tavernën "...” në S..., Komuna e Leposaviqit, nën ndikimin e alkoolit prej 2,2 g/kg, pa asnjë arsye ka filluar një debat verbal me R.R, i cili punonte si kamerier në tavernën e lartpërmendur dhe ishte në shoqërinë e K..., Z... dhe D.Z. e që gjatë gjithë kohës e provokoi dhe e ofendoi, pas së cilës i dëmtuari i tha të dilte jashtë dhe të mos krijonte probleme

në tavernë – lokal, kështu që D.M e ftoi të dilte jashtë lokali për ti thënë diçka, e kapi për xhakete me të dyja duart, duke e goditur në kokë në zonën e hundës, duke i shkaktuar ndrydhje të indeve e buta në regjionin e hundës me një thyerje të kockës së hundës me zhvendosje kockore – lëndime të rënda trupore.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, pika 1.3 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, e 186 par.1 pika 1.3 të KPRK-ës, dhe nenit 358, 364, 449, 460 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME BURGIM të kushtëzuar në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën njëzet (20) euro, ndërsa për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Pala e dëmtuar R.R udhëzohet që kërkesën pasuroro-juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil

A R S Y E T I M

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1526/21, të datës 03.12.2021, ndaj të pandehurit D.M, për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, pika 1.3 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 15.04.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit D.M me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.Festim Shala.

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues. Ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, duke premtuar se më nuk do të përsërisë vepra të tilla. I njëjti ka theksuar se më të dëmtuarin kanë mbetur shokë dhe se ai nuk është i pajtimit që i pandehuri të ndiqem penalisht.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurorja e Shtetit Ajtene Zoni, propozoi gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe ka mbështetje në faktet e çështjes që përmban kjo aktakuzë. Nga gjykata ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptohet një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo vlerës së mbrojtur.

Mbrojtësi e të pandehurit, av.Festim Shala, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin që të miratohet pranimi i fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë ka ardhur pas konsultimeve të mjaftueshme me të, në mënyrë vullnetare dhe pa imponim, si dhe është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, ka theksuar që të merren parasysh sjelljet e mira të tij dhe paraqitja serioze në raport me gjykatën dhe palët, faktin se nuk ka qenë më parë i dënuar, shprehjen e pendimit të thellë, moshën e tij të shtyrë si dhe fatin se ka kaluar një kohë prej që ka ndodhur rasti.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar e pandehuri D.M, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin të fajësisë për të pandehurën. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021/SE/031 i datës 25.03.2021; Raporti i shpejtë me numër të rastit 2021/SE/031 i datës 3.03.2021; Raporti policor i datës 23.03.2021 dhe Shënimi zyrtar i datës 25.03.2021; Deklarata e të dëmtuarit e datës 24.03.2021; Deklaratat e dëshmitarëve D.Z, Z.K të datës 24.03.2021; Deklarata e të pandehurit e datës 19.08.2021 dhe e datës 25.11.2021; Procesverbali mbi pranimin

e alkoolit në organizëm i datës 23.03.2021; Raportet mjekësorë për të dëmtuarin; Foto albumi nga shkresat e lëndës; Akt ekspertimi mjeko ligjor lidhur me konstatimin e natyrës së lëndimeve trupore i datës 01.10.2021; si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, pika 1.3 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata i'a kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri D.M është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1, pika 1.3 të KPRK-së.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin D.M, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, pra dashjen e tij, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë vepër penale, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, keqardhjen e shprehur para gjykatës dhe premtimin e dhënë se më nuk do të përsërisë vepra të tilla, pastaj faktin se me të dëmtuarin kanë raporte të mira tashmë, pastaj rrethanat personale të tij, moshën e tij të shtyrë

dhe i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit të kushtëzuar, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurin. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Shpenzimet procedurale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në pikën III të aktgjykimit duke e udhëzuar palen e demtuar që kërkesen pasuroro-juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 460 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.154/2021, datë 02.05.2024

Bashkëpunëtoe Profesionale
Edita Koliqi

Gjyqtarja
Qëndresa Tahiri Islami

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.